

POLICIA NË SHËRBIM TË QYTETARËVE

PARASHTRIMI I ANKESAVE

PËR PUNËN E POLICISË



Shërbimit të Inspektorit të përgjithshëm të RSP-së:
Bulevar AVNOJ-a 104, 11070 Beograd
Telefon/Fax: 011/311-76-88



oebs

ORGANIZATA PËR SIGURI DHE
BASHKËPUNIM EVROPIAN

Misioni i OSBE-së në Serbi dhe Mal të Zi

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME E REPUBLIKËS SË SERBISË
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
SHËRBIMI I INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM
MISIONI I OSBE-SË NË SERBI DHE MAL TË ZI

1. A duhet të parashtrorj ankesë/ parashtrësë për punën e shërbimit policor?

Ankesë për punën e anëtarit të shërbimit policor dhe punëtorëve tjerë të Ministrisë së Punëve të Brendshme mund të parashtroni nëse keni vërejtur ndonjë parregullsi dhe lëshim në punën e tyre, respektivisht nëse mendoni se:

- kanë qenë të pasjellshëm ndaj jush,
- kanë përdorur forcë të tepërt,
- ju kanë arrestuar paligjshëm, ose
- i kanë shkellur të drejtat e juaja në ndonjë mënyrë tjetër.

Duke tërhequr vërejtje për sjellje të paligjshme dhe joprofesionale të anëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, qytetarët janë duke i ndihmuar Shërbimit të Inspektorit të përgjithshëm të Resorit të Sigurisë Publike (RSP) për të vërtetuar shpërdorime dhe parregullsi tjera dhe për të ndërmarrë masa të përcaktuara me ligj.

2. Çka duhet shënuar në ankesë?

Në ankesë duhet t'i shënoni këto gjëra:

- përshkrim të shkurtër për sjelljen e anëtarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për shkak të së cilit ju jeni duke e parashtruar ankesën/parashtrësën (kohën, vendin e ngjarjes, dhe të dhëna tjera të dobishme siç janë: numri i shenjës zyrtare të policit, numri i targave të automjetit zyrtar, dhe të ngjajshmët),
- a ka dëshmitarë tjerë përveç juve dhe policit dhe si mund të kontaktohet polici,
- përveç pasojave të sjelljes së anëtarit të Ministrisë për të cilin jeni duke u ankuar (të gjitha dëshmitë për lëndim ose dëm: dokumentacioni mjekësor, foto dokumentacioni dhe të tjerat),
- të dhënat personale të parashtruesit të ankesës, duke e përfshirë adresën e vendbanimit, nëse parashtruesi i ankesës dëshiron të parashtrorj ankesë me emrin dhe mbiemrin e plotë të tij, gjë e cila këshillohet.

Ankesa/ parashtrësja mund të jete edhe anonime.

Ankesa mund të jetë e parashtruar me shkrim ose gojarisht.

Këshillohet që ketë ta bëni në afat sa më të shkurtër pas ngjarjes për të cilën është bërë ankesa.

3. Si të parashtrorj ankesë/parashtrësë?

Ankesën/ parashtrësën kundër anëtarit të Ministrisë mund ta parashtroni në:

- Shërbim të Inspektorit të përgjithshëm të RSP-së,
- Sekretariat të më të afërtë të Punëve të Brendshme (SPB), në Departamentin e Punëve të Brendshme (DPB) në afërsi, ose në stacionin policor dhe në
- Byronë për ankesat e qytetarëve pranë Kabinetit të ministrit të Punëve të Brendshme.

Ankesën mund ta paraqitni personalisht ose me ndërmjetësim të përfaqësuesit të autorizuar (për shembull, ndonjë organizatë joqeveritare e cila ofron ndihme juridike, ose avokati i juaj). Për të qenë ndokush në mundësi të jetë përfaqësuesi i juaj, duhet ta autorizoni me shkrim.

4. Çka do të ndodhë me ankesën/parashtrësën time?

Pas pranimit të ankesës Shërbimi i Inspektorit të përgjithshëm i RSP-së do të fillojë me kontrollimin e hollësishëm të të dhënave:

- do të bisedojë me parashtruesin e ankesës/parashtrësës, me dëshmitarët dhe me të tjerët për të cilët vlerësohet se janë të njohtuar me ngjarjen e përshkruar në ankesë,
- do ta vërtetojë identitetin e anëtarit të Ministrisë kundër të cilit është parashtruar ankesa/parashtrësja, nëse identiteti i tij nuk është përmendur, si edhe vërtëtimi i identitetit të personave tjera të përmendura në ankesë,
- do të përbmledhë dhe të vërtetojë dokumentacionin zyrtar,
- do të gjejë dhe vërtetojë dokumentacionin mjekësor dhe të tjerat që mund të shërbenin për vërtëtimin e fakteve,
- do të kryejë edhe vërtetime tjera të nevojshme.

5. Çka do të ndohë pas kontrollimit të ankesës sime?

Parashtruesi i ankesës/ parashtrësës patjetër do të jetë i informuar për rezultatet e vërtetimit dhe për masat që do të ndërmirren ndaj punonjësëve përgjegjës të Ministrisë.

Nëse konstatohet se ankesa është e bazuar do të parashtrorjet:

- kallëzimi penal pranë Prokurorisë kompetente, nëse ekziston dyshimi i bazuar se është kryer një veprë penale,
- kallëzimi kundërvajtës pranë Gjykatës Komunale kompetente për kundërvajtje, nëse vërtëtohet se fjala është për kundërvajtje,
- kallëzimi disiplinor dhe kërkesa për ngritjen e procedurës disiplinore në rast të shkeljes së obligimeve dhe detyrave të punës. Parashtruesi i ankesës do të jetë i njohuar me kohë dhe hollësisht për nevojë të mundshme për paraqitjen në rolin e dëshmitarit për diskutim rreth procedurës disiplinore.

Në të njëjtën kohë, kundër secilit person i cili parashtron kallëzim penal të rremë kundër anëtarit të Ministrisë, mund të jetë e ngritur procedura penale pranë Gjykatës kompetente. Gjithashtu, anëtari i Ministrisë kundër të cilit është parashtruar kallëzimi penal i rremë mund të parashtrorj akuzë kundër parashtruesit në gjykatën kompetente.

6. Çka nëse policia nuk ndërmerr asgjë? A mund ta parashtrorj akuzën pranë Gjykatës?

Nëse asgjë nuk mund të ndërmirret në bazë të ankesës suaj, Shërbimi i Inspektorit të përgjithshëm do t'ju informojë për atë me shkrim.

Nëse si parashtruesi i ankesës nuk jeni të kënaqur me masat e ndërmarrja për vërtëtimin e akuzave, ose nuk jeni të kënaqur me përfundimin e procedurës, mund të:

- parashtroni kallëzim penal drejtpërdrejt pranë Prokurorit shtetëror kompetent, nëse mendoni se në sjelljen e anëtarit të Ministrisë ka elemente të veprës penale,
- parashtroni akuzë private pranë Gjykatës kompetente për veprat penale që ndiqen sipas akuzës private,
- filloni procedurën për dëmshpërblim pranë gjykatës kompetente.

Kërkesat për këshill për ngritjen e procedurave të këttilla i drejtoni te Shërbimi për ndihmë juridike në komunën e juaj ose avokatit.

7. Çka nëse nuk dëshiroj të bashkëpunoj pas paraqitjes së ankesës/ parashtrësës?

Gjërat e përmendura në të gjitha ankesat dhe parashtrësja – të nënshkuara dhe anonime – Shërbimi i Inspektorit të përgjithshëm i RSP-së i kontrollon hollësisht.

Mëgjithatë, nëse parashtruesi i ankesës/parashtrësës pranon bashkëpunim, ngjarja për të cilën personi është ankuar do të jetë e zgjidhur më lehtë dhe më plotësisht.

8. Shërbimi i Inspektorit të përgjithshëm i RSP -së

Shërbimi i Inspektorit të përgjithshëm është njësi organizative e re e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë.

Është e ngarkuar për ndërmarrjen e masave për ndriçimin dhe parandalimin e kriminalitetit, korrupsionin dhe për parregullsitë tjera në punë dhe sjellje joprofesionale të anëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pa marrë parasysh gradën dhe pozicionin.

Shërbimi përkushton kujdes të posaçëm në kontrollimin e ankesave të qytetarëve për të ndërmarrë masa ligjore kundër të gjithë anëtarëve të Ministrisë të cilët janë sjellur në mënyrë të paligjshme dhe joprofesionale. Në suazë të këtij shërbimi ekziston edhe Departamenti për parashtrësja, i cili i kontollon të gjitha ankesat dhe i cili ndërmerr masa kundër punëtorëve përgjegjës.

Adresa e Shërbimit të Inspektorit të përgjithshëm të RSP-së:

MPB e Serbisë, Shërbimi i Inspektorit të përgjithshëm të RSP-së,
Bulevar AVNOJ-a 104, 11070 Beograd, Telefoni: 011/ 311-76-88,
Kompetent për ankesat e qytetarëve posta elektronike: inspektor@mup.sr.gov.yu